

Informacion i shkurtër

Si i zhvillojmë bisedat në periudhën parashkollore?

Qëllimi **Ne dëshirojmë që të gjithë fëmijët, që nga hyrja në kopshtin për fëmijë, të mund të zhvillohen mirë si nga ana personale ashtu edhe nga ajo shkollore.** Për ta arritur këtë qëllim, është e dobishme që në fazën fillore personeli profesionist shkollore dhe prindërit – ndoshta së bashku edhe me persona të tjerë, të cilët kanë të bëjnë me fëmijën – të ulen së bashku në një bisedë shkollore në referim të shkollimit që u paraprin fëmijëve.

Këta biseda kanë një rrjedhë të caktuar. Kjo ndihmon personelin profesionist shkollore në fazën fillore të shkollimit dhe prindërit për të gjetur së bashku temat e rëndësishme të vërteta, për të shkëmbyer vërtetimet dhe për të gjetur së bashku, se çfarë është e dobishme për një hyrje të suksesshme në kopshtin për fëmijë.

Ky informacion i shkurtër përshkruan hapat e rëndësime të kësaj rrjedhe. Informacione më të sakta të procedurës «Schulische Standortgespräche (biseda në shkollë)» mund ti gjeni në këtë faqen e internetit: www.vsa.zh.ch/ssg.

Kur bëhet një takim bisedues për shkollimin? Një takim bisedues për futjen në shkollë zhvillohet, në qoftë se fëmijës që nga hyrja në kopsht i nevojitet eventualisht masa të shkollës së specializuar ose masa të veçanta pedagogjike të shkollës së rregullt. Pra në rastet kur nevojitet të testohen:

- Masat e shkollimit të specializuar siç është shkollimi i specializuar integruar në përgjegjësinë e shkollës së rregullt (ISR), shkollimi i specializuar integruar në përgjegjësinë e shkollës së specializuar (ISS), këshillim dhe përkrahje në rast të aftësive të kufizuara fizike ose pamore apo në një shkollim ditor ose në një shkollim të veçantë në konvikt.
- Masat e veçanta pedagogjike të shkollës së rregullt dhe bashkë me këtë edhe terapia logopedike, terapia psikomotorike, terapia psikike, ofertat audio pedagogjike, mësimi pranues dhe përkrahja integruar (IF).

Kush merr pjesë në takimin bisedues shkollore? Në bisedë duhet të marrin pjesë ata persona, të cilët janë të rëndësishëm për sqarimin e situatës. Gjithmonë janë personat profesionistë në fazën fillore të shkollës si dhe prindërit të pranishëm (babai dhe/ose nëna).

Sa zgjat biseda shkollore? Normalisht biseda zgjat një orë.

Kush e udhëheq bisedën shkollore? Normalisht biseda udhëhiqet nga personi profesionist në fazën fillore shkollore.

Kush fton për bisedën? Normalisht fton ai person, i cili do ta udhëheqë bisedën shkollore.

Si mund të përgatitem unë për bisedën? Të gjithë pjesëmarrësit përgatiten për bisedën, duke e plotësuar formularin përgatitor «Persönliche Vorbereitung eines Standortgesprächs» (Përgatitja individuale mbi bisedën shkollore). Formulari përgatitor ndihmon, për të gjetur shpejt dhe së bashku, se cilat tema janë të rëndësishme, për të cilat duhet të flitet.

Si duhet ta plotësoj formularin për përgatitje?	<p>Në formular Ju shënoni përshkrimin tuaj personal të situatës së tashme: «Çfarë është për momentin e vështirë, çfarë speciale? Cili është problemi më i rëndësishëm nga pikëpamja ime? Ku i shoh unë pikat e forta të fëmijës tim?»</p> <p>Në vijim, kaloni formularin tejteje dhe mendoni te të gjitha pikat, nëse Ju, sa i përket fëmijës Tuaj, përjetoni një pikë të fortë apo një problem. Një lëmi quhet për shembull «Reagimi ndja kërkesave». Nëse Ju jeni të mendimit, se fëmija Juaj këtu pak a shumë mund të vlerësohet njëlloj si shokët e tij moshatarë, atëherë kryqëzoni Ju fushën në mes. Ndonjëherë është e vështirë të vendosni vetëm një kryq. Në këtë rast Ju mund të vendosni më shumë kryqe. Për vërejtje të tjera, keni vend djathtas.</p> <p>Formulari i plotësuar është i Juaj dhe kështu Ju mund ta merrni atë mbas bisedës me vete në shtëpi.</p>
Sa kohë më nevojitet mua për plotësimin?	<p>Merrni 5 deri në 10 minuta kohë, më shumë jo. Më shumë bëhet fjalë këtu për një vlerësim të përgjithshëm, i cili do të ndihmojë shumë për bisedën.</p>
Duhet ta plotësojë të gjithë?	<p>Jo. Nëse Ju mendoni, «Unë këtë nuk mundem ta vlerësojë» ose «Për këtë, unë më mirë nuk dëshiroj të them gjë», atëherë lerën Ju fushat e parapara për këtë thjesht bosh.</p>
Si zhvillohet biseda shkollore?	<p>Në pjesën e parë të bisedës shihen vlerësimet e ndryshme mbi formularin përgatitor. («Nga ku i kanë të gjithë të njëjtat vlerësime? A ka fusha, të cilat vlerësohen ndryshe?») Tani vlerësohet së bashku, mbi cilat (një deri dy) fusha duhet të bisedohet më në thellësi. Të gjithë pjesëmarrësit mund të sjellin me vete vrojtimit e tyre.</p> <p>Në pjesën e fundit të bisedës qëndron në qendër pyetja në vijim: «A duhet të testohen tek fëmija im masat për shkollën speciale apo masat e veçanta pedagogjike të shkollës së rregullt?»</p>
A ka një protokoll të kësaj bisede shkollore?	<p>Po, hartohet një protokoll i shkurtër.</p> <p>Në faqen e fundit të protokollit shënohet se cilat qëllime duhet të ndiqen së bashku. Nëse për fëmijën Tuaj duhet të testohet për futjen në shkollë një masë e veçantë pedagogjike, atëherë dokumentohet edhe kjo.</p> <p>Të gjithë pjesëmarrësit në bisedë marrin një kopje të kësaj faqe të protokollit (protokoll i shkurtër)</p>
Cilat janë hapat në vijim mbas bisedës shkollore?	<p>Nëse pjesëmarrësit në bisedë vijnë në përfundim se një masë e shkollimit të veçantë ose një masë e veçantë pedagogjike e shkollës së rregullt duhet të testohet, atëherë ata e plotësojnë së bashku «formularin për regjistrim për kalimin kohën e hershme-shkollë për testimin e masave të veçanta pedagogjike».</p> <p>Formulari i plotësuar regjistruet së bashku me protokollin e shkurtër të bisedës i dërgohet administratës përgjegjëse të shkollës, në lagjen e prindërve.</p> <p>Në qoftë se masat për një shkollim të veçantë janë në diskutim atëherë administrata përgjegjëse shkollore së bashku me komisionin shkollor kujdeset për lajmërimin tek shërbimi psikologjik adekuat shkollor.</p> <p>Në qoftë se masat e veçanta pedagogjike të shkollës së rregullt janë në diskutim atëherë administrata përgjegjëse shkollore së bashku me drejtorinë e shkollës kujdesen për thirrjen e prindërve në një bisedë. Drejtoria shkollore në bazë të situatës fton për këtë mësuesit dhe personelin specialist dhe kujdeset më parë për pëlqimin e prindërve në rast të sqarimeve të duhura nëpërmjet pedagogëve specialist të shkollës.</p> <p>Nëse nuk nevojitet një testim i masave të veçanta pedagogjike, atëherë mbas bisedës për futjen në shkollë nuk duhet të ndërmerret asgjë.</p>